**Shkolla e Mesme Profesionale**
**“Beqir Çela”**
**Durrës**

Adresa:Lagjia Nr.14 Shkozet-Durres,tel:052264525,e-mail:bcelamt@yahoo.com, beqircela.edu.al


Nr. 130 Prot Durres, më 14.05.2021



# RAPORTI:

# VETËVLERËSIMI I INSTITUCIONIT

# PERIUDHA: 2019-2020

**KRYETARI I BORDI**
LUIGJ ALEKSI

**DREJTORI I SHKOLLES**
FATMIR MERKURI

## Pasqyra e lëndës

1. Përmbledhje e vetëvlerësimit ........ 4
2. Metodologjia ........ 5
3. Të dhëna për institucionin ........ 6
4. Vetëvlerësimi i institucionit ........ 7
   4.1. Treguesit dhe nënfushat që janë vlerësuar ........ 8
   4.2. Gjetjet ........ 9
   4.3. Gjykime dhe konkluzione ........ 12
   4.4 . Vlerësimi ........ 13
   4.5 Rekomandimet ........ 14

BEQIR ÇELA

# **Përgatitur nga:**

Ekipi qëndror i vetëvlerësimit:

1. Fatmir Merkuri (kryetar)
2. Mimoza Zhamo (anëtar)
3. Nazmi Kasmi (anëtar)

*Hartimi i këtij raporti u bë i mundur me mbështetjen e të gjithë stafit të institucionit, të cilët i falenderojmë për përkushtimin dhe energjinë që i kanë kushtuar këtij proçesi të rëndësishëm duke na mbështetur me dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e këtij proçesi.* Kjo na ka dhënë mundësinë për të shqyrtuar dhe verifikuar çdo të dhënë dhe material të nevojshëm për vetëvlerësimin.

Anëtarët e stafit si më poshtë:

| Nr | Emër Mbiemër | Nr | Emër Mbiemër | Nr | Emër Mbiemër |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Fatmir Merkuri | **28** | Jovana Hebibasi | **55** | Romeo Shkodrani |
| **2** | Mimoza Zhamo | **29** | Koco Dolani | **56** | Spartak Rigo |
| **3** | Etleva Kacanja | **30** | Euglent Ceci | **57** | Arta Cafuli |
| **4** | Roland Dema | **31** | Marsida Ahmeti | **58** | Aleksander Konduri |
| **5** | Arben Marra | **32** | Marinela Suçi | **59** | Petrit Bardhi |
| **6** | Nazmi Kasmi | **33** | Elvira Rruga | **60** | Ilir Kertusha |
| **7** | Shefki Kastrati | **34** | Klodiana Mehja | **61** | Franci Kraja |
| **8** | Saimir Laci | **35** | Hilmi Xhaferri | **62** | Thoma Llazari |
| **9** | Gurim Kaci | **36** | Lefteri Kasmi | **63** | Aneo Heba |
| **10** | Manjola Sharkaj | **37** | Renata Kolaj | **64** | Fatjon Hajdari |
| **11** | Dorina Murati | **38** | Rudina Tereziu | **65** | Maksim Bengu |
| **12** | Marjeta Milloshi | **39** | Oltiana Balliu | **66** | Ilirjan Gaxholli |
| **13** | Eduart Mele | **40** | Borana Meçe | **67** | Petrit Mezini |
| **14** | Elton Pasterma | **41** | Silvana Ferzaj | **68** | Dorjan Myftari |
| **15** | Llambi Kallco | **42** | Markelian Laho | **69** | Makbule Dervishi |
| **16** | Jasmina Agaj | **43** | Myzejen Alite | **70** | Qazim Xhameta |

BEQIR ÇELA

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **17** | Matilda Vora | **44** | Banush Dollani | **71** | Eva Prenga |

BEQIR ÇELA

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **18** | Alba Dervishi | **45** | Kudret Guce | **72** | Natasha Gjikoli |
| **19** | Ada Shtino | **46** | Ermir Fraholli | **73** | Fabian Saraci |
| **20** | Heliona Licaj | **47** | Andi Xhako | **74** | Luan Hasanaj |
| **21** | Olgerta Shaba | **48** | Jetlinda Krasniqi | **75** | Bledar Alla |
| **22** | Zinaida Deda | **49** | Petrit Hoxha | **76** | Ornela Shaba |
| **23** | Artur Karruli | **50** | Besjana Kola | **77** | Eva Prenga |
| **24** | Esterina Prendi | **51** | Adelina Çela | **78** | Benereta Qiro |
| **25** | Floriana Stefani | **52** | Ramiz Kadriu | | |
| **26** | Engjell Seferasi | **53** | Altin Minga | | |
| **27** | Ismet Ismaili | **54** | Roland Ziaj | | |
| PUNONJËS MBËSHTETËS | | | | | |
| 1 | Xhemaile Shqopa | **6** | Tomorr Laze | **10** | Erjon Gumeni |
| 2 | Pranvera Plaku | **7** | Leonard Hodo | **11** | Baftjar Zaimi |
| 3 | Leonora Sinamati | **8** | Marjeta Mehmeti | **12** | Gezim Sula |
| 4 | Lirije Boriçi | **9** | Sabrie Margjeka | **13** | Zymer Dervishaj |
| 5 | Bajame Fico | | | | |

Shkolla “Beqir Çela” kërkon gjithmonë të jetë në lartësinë e emrit dhe historisë së saj,si një nga shkollat më të mira profesionale në vend.Për të arritur rezultate të larta stafi mësimor, me profesionalizëm dhe përkushtim, përcjell tek nxënësit njohuritë dhe shprehitë teorike dhe praktike për ti përgatitur specialistë të kualifikuar.

Shkolla krijon kushtet për realizimin e mësimit cilësor dhe bashkëkohor përmes të cilit do të mundësohet plotësimi i nevojave dhe interesave të nxënësve.

Vëmëndje e veçantë i kushtohet rritjes së cilësisë të praktikave profesionale për tëpërgatitur specialistë të aftë që i përgjigjen kërkesave të tregut të punës.

Nxënësit e shkollës tonë ndjekin drejtime profesionale bashkëkohore,çertifikatat e të cilave njihen si brenda dhe jashtë vendit dhe u ofrojnë atyre mundësi të mëdha për të gjetur punëtë kualifikuar.

BEQIR ÇELA

# 1. PËRMBLEDHJE E VETËVLERËSIMIT

## *Fusha e vleresuar "* **Kurrikula e zbatuar (2019-2020)** *".*

Gjatë vitit shkollor 2019-2020 proçesi mësimor dhe edukativ në shkollën e mesme profesionale "Beqir Çela", u zhvillua në kushte jo shumë jo të përshytatshme për mësimdhënie për shkak të numrit të madh të nxënësve dhe ambjenteve mësimore, jo të mjaftueshme.Gjithashtu gjatë këtij viti shkollor vështirësi të shtuara pengesë për realizimin e objektivave të përcaktuara ,ishin edhe tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe situata e pandemisë në Mars 2020. Pavarësisht këtyre faktorëve të paparashikuara, i gjithë stafi drejtues dhe mësimdhënës kanë qënë të përkushtuar për mbarëvajtjen dhe realizimin e proçesit mësimor për arritjen e objektivave të përcaktuara në fillim të vitit shkollor.

**Statistika për nxënësit për vitin shkollor 2018-2019**

- Ndjekja e shkollës
- Regjistruar 1617 nxënës,nga këta 1614 meshkuj dhe 3 femra
- Viti I ka 11 klasa paralele
- Viti II ka 11 klasa paralele
- Viti III ka 11 klasa paralele
- Viti IV ka 11 klasa paralele

| | |
|---|---|
| Kalueshmëria | 98.52% |
| Nota mesatare | 6.37 |
| Larguar nga shkolla | 9.21% |
| Koefiçenti i mungesave pa arsye | 0.40% |

**Statistika për nxënësit për vitin shkollor 2019-2020**

- Ndjekja e shkollës
- Regjistruar 1489 nxënës,nga këta 1489 meshkuj
- Viti I ka 11 klasa paralele
- Viti II ka 11 klasa paralele
- Viti III ka 11 klasa paralele
- Viti IV ka 11 klasa paralele

| | |
|---|---|
| Kalueshmëria | 99.56% |
| Nota mesatare | 6.57 |
| Larguar nga shkolla | 8.26% |
| Koefiçenti i mungesave pa arsye | 0.45% |

Për këtë vit shkollor pjesë e vazhdueshme e punës së stafit mësimor ka qënë edhe mbështetja e proçesit të vetëvlerësimit të shkollës , si faktor i rëndësishëm për një reflektim real të arritjeve të deritanishme dhe nevojave për përmirësim në drejtim të kurrikulës së zbatuar në shkollë .

BEQIR ÇELA

# 2. METODOLOGJIA

Fillimisht proçesi i vetvlerësimit nisi me ngritjen e ekipit qëndror , i cili përzgjodhi dhe fushën që do të merrej në shqyrtim për vetvlerësimin e Shkollës, **"Kurrikula e zbatuar ".**

Pas shqyrtimit të kritereve të çdo nën/fushe , ekipi qëndror ngriti dhe ekipin mbështetës për realizimin e këtij proçesi. Përzgjedhja e anëtarëve të ekipit mbështetës u bë duke patur parasysh funksionin e tyre si kryetarë të ekipeve lëndore gjatë vitit shkollor 2019-2020 .

Bazë e këtij proçesi ka qënë bashkëpunimi midis mësuesve të kulturës së përgjithshme , teorisë profesionale dhe Instruktorëve të praktikës profesionale.

Për realizimin e proçesit të vetëvlerësimit u ndoqën këto hapa pune:

1.Ngritja e komisionit qëndror.

2. Ngritja e ekipit mbështetës dhe ndarja e detyrave:

- Manjola Sharkaj
- Rudina Tereziu
- Dorina Konomi
- Gurim Kaçi
- Euglent Ceci
- Arben Marra

**3.**Mbledhja e të dhënave të institucionit për fushën e zgjedhur **" Kurrikula e zbatuar"**

4. Përpunimi i të dhënave.

Të dhënat e mbledhura u analizuan duke u shqyrtuar në bazë të kërkesave të secilës nënfushë për të pasqyruar një vlerësim sa më objektiv ,duke ndihmuar në përcaktimin e drejtë të arritjeve dhe nevojave për përmirësim në fushën: " Kurrikula e zbatuar".

**5.**Plotësimi me të dhënat e përpunuara në platformën: ***https://scvet.al/platforma***

6.Përgatitja e raportit të vetëvlerësimit për fushën " Kurrikula e zbatuar"

7.Miratimi i raportit të vetëvlerësimit nga këshilli i mësuesve / bordi i shkollës .

8.Hedhja e raportit final të vetëvlerësimit në platformën digjitale

BEQIR ÇELA

# 3. TË DHËNA PËR INSTITUCIONIN

| | |
|---|---|
| **Emri i shkollës** | **“Shkolla e Mesme Profesionale Beqir Çela “** |
| Adresa | Lagja 14 , Shkozet , Durres . |
| Telefoni | 052 264 528 |
| e-mail | bcelamt@yahoo.com |
| Website | beqircela.vet.al, beqircela.edu.al |
| Viti i ndërtimit | 2018 |
| Sipërfaqja e laboratoreve dhe klasave të teorisë | 3090 $m^2$ |
| Sipërfaqja e reparteve të praktikës | 1943 $m^2$ |
| Sipërfaqja e ambienteve sportive. | Palestra 360 $m^2$ Ambejnti jashtem 640 m2 |
| Numri i klasave | 44 |
| Numri i stafit pedagogjik | 78 |
| Psikolog | **1** |
| Numri i personelit ndihmës. | 12 |

BEQIR ÇELA

# 4. VETËVLERËSIMI I INSTITUCIONIT

**4.1.FUSHA E VLERËSUAR : KURRIKULA E ZBATUAR.**

## 3.2. Treguesit dhe nënfushat që janë vlerësuar

**Nënfushat:**
**1. Kurrikula në bazë shkolle të AFP-së**

**(VLERËSIMI: SHUMË MIRË, 1.4 )**

1.1. Plani i zhvillimit të orëve mësimore/Plani mësimor zbatohet në përputhje me kërkesat e Skeletkurrikulës së Kualifikimeve Profesionale.
1.2. Programet e mësimdhënies teorike profesionale zbatohen në përputhje me kërkesat e Skeletkurrikulës së Kualifikimeve Profesionale.
1.3. Programet e mësimdhënies së moduleve praktike profesionale zbatohen në përputhje me kërkesat e Skeletkurrikulës së Kualifikimeve Profesionale.

**3. Kurrikula e formimit të përgjithshëm**

**(VLERËSIMI : MIRË 1.8)**

3.1. Plani tremujor ose vjetor lëndor zbatohet në përputhje me kërkesat zyrtare të dokumenteve kurrikulare.
3.2. Plani ditor hartohet sipas rekomandimeve të kurrikulës duke synuar arritjen e rezultateve të të nxënit nga nxënësit
3.3. Mësuesi harton në planin ditor dhe rezultate për zhvillimin e aftësive dhe temave

Ndërkurrikulare
3.4. Mësuesi realizon projekte kurrikulare që i ndihmojnë nxënësit të përpunojnë njohuritë e mësuara dhe të zhvillojnë më tej aftësitë ndërkurrikulare

BEQIR ÇELA

## 4. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës

**(VLERËSIMI:MIRË 1.6)**

4.1. Mësuesit përzgjedhin tekstet e nxënësve.

4.2. IoAFP është e pajisur në mënyrë të mjaftueshme me laboratorë dhe mjete mësimore për zhvillimin e lëndëve teorike.

4.3. IoAFP disponon mjedise të veçanta për realizimin e moduleve dhe të praktikave profesionale.

## 5. Ekipi kurrikular i IoAFP-së

**(VLERËSIMI:SHUMË MIRË 1.3)**

5.1. Ekipi kurrikular, ai lëndor dhe ai i instruktorëve në IoAFP luajnë një rol parësor në planifikimin dhe zbatimin e një kurrikule që përmbush kërkesat e kualifikimeve profesionale që ofron.

**VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR PËR FUSHËN ËSHTË:**

**MIRË (1.6)**

BEQIR ÇELA

## 4.3. Gjetjet

Në bazë të rezultateve të nxjerra, institucioni është vlerësuar pozitivisht për të gjitha fushat dhe nënfushat e tij. Gjatë proçesit të vetvlerësimit është konstatuar që në tërësi institucioni në veprimtarinë e tij funksionon duke zbatuar kriteret dhe orientimet e AKAFPK-së.

| Nënfusha | Treguesi | Nivelet e vlerësimit | Pikët |
|---|---|---|---|
| **1. Kurrikula në bazë shkolle të AFP-së** | 1.1. Plani i zhvillimit të orëve mësimore/Plani mësimor zbatohet në përputhje me kërkesat e Skeletkurrikulës së Kualifkimeve Profesionale. | Shumë mirë | 1.3 |
| | 1.2. Programet e mësimdhënies teorike profesionale zbatohen në përputhje me kërkesat e Skeletkurrikulës së Kualifkimeve Profesionale. | Shumë mirë | 1.4 |
| | 1.3. Programet e mësimdhënies së moduleve praktike profesionale zbatohen në përputhje me kërkesat e Skeletkurrikulës së Kualifkimeve Profesionale. | Shumë mirë | 1.5 |
| **3. Kurrikula e formimit të përgjithshëm** | 3.1. Plani tremujor ose vjetor lëndor zbatohet në përputhje me kërkesat zyrtare të dokumenteve kurrikulare. | Shumë mirë | 1.2 |
| | 3.2. Plani ditor hartohet sipas rekomandimeve të kurrikulës duke synuar arritjen e rezultateve të të nxënit nga nxënësit | Mirë | 1.7 |
| | 3.3. Mësuesi harton në planin ditor dhe rezultate për zhvillimin e aftësive dhe temave ndërkurrikulare | Mjaftueshëm | 2.5 |
| | 3.4. Mësuesi realizon projekte kurrikulare që i ndihmojnë nxënësit të përpunojnë njohuritë e mësuara dhe të zhvillojnë më tej aftësitë ndërkurrikulare. | Mirë | 2.3 |
| **4. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës** | 4.1. Mësuesit përzgjedhin tekstet e nxënësve. | Shumë mirë | 1.4 |
| | 4.2. IoAFP është e pajisur në mënyrë të mjaftueshme me laboratorë dhe mjete mësimore për zhvillimin e lëndëve teorike. | Mirë | 1.7 |
| | 4.3. IoAFP disponon mjedise të veçanta për realizimin e moduleve dhe të praktikave profesionale. | Mirë | 1.5 |
| **5. Ekipi kurrikular i IoAFP-së** | 5.1. Ekipi kurrikular, ai lëndor dhe ai i instruktorëve në IoAFP luajnë një rol parësor në planifkimin dhe zbatimin e një kurrikule që përmbush kërkesat e kualifkimeve profesionale që ofron. | Shumë mirë | 1.3 |

## *N nf#usha 1:* Kurrikula në bazë shkolle të AFP-së

Shkolla e Mesme Profesionale “ Beqir Çela “ gjatë vitit shkollor 2019-2020 për hartimin e planit mësimor është mbështetur në planet mësimore të pasqyruara në skeletkurrikulat e Kualifikimit profesional në këto drejtime :

1. Teknologji Informacioni dhe Komunikimi dhe Instalimi i pajisjeve Termohidraulike.
   Për këto dy drejtime në hartimin e planeve mësimore është respektuar numri i orëve dhe shpërndarja e tyre sipas parashikimeve në skeletkurrikulën e Kualifikimit Profesional.
   Për zbatimin sa më korrekt në përputhje me orët e përcaktuara, drejtoria e Shkollës ka organizuar mësimin me grupe ( në dy turne ) duke shfrytëzuar maksimalisht ambjentet mësimore si në zhvillimin e teorisë ashtu edhe të praktikës profesionale .
2. Për drejtimin SH.M.T. dhe Elektroteknikë hartimi i planeve mësimore si dhe shpërndarja e orëve mësimore është mbështetur:
   - Për klasat e X-ta dhe të XIII-ta në skeletkurrikulën e Kualifikimit Profesional duke zbatuar me përpikmëri orjentimet në skeletkurrikul.
   - Për klasat e XI-ta dhe të XII-ta të këtyre drejtimeve është mbështetur në strukturën pilot të miratuar sipas shkresës ,Nr prot.22, data 03.09.2012 ku periudha mësimore është ndarë në 50% të kohës është zhvilluar mësimi i teorisë profesionale dhe 50% mësimi i praktikës profesionale.

Kjo ka sjellë edhe ndryshim të planeve mësimore , programeve të mësimdhënies, dhe orëve të zhvilluara. Si në mësimin teorik edhe në atë praktik.Hartimi i programeve të mësimdhënies të lëndëve teorike edhe të moduleve të praktikës profesionale është bërë nga ekipet lëndore përkatëse të cilat janë organizuar duke u mbështetur dhe në drejtimet profesionale që zhvillon shkolla.

1. Ekipi lëndor i SH.M.T.
2. Ekipi lëndor Elektroteknikë
3. Ekipi lëndor Mekaniku i përgjithshëm
4. Ekipi lëndor TIK
5. Ekipi lëndor Shkenca Shoqërore
6. Ekipi lëndor Shkenca natyrore

Organizimi i mësuesve në ekipe lëndore sipas kualifikimeve të tyre profesionale ka bërë që gjatë hartimit të programeve të mësimdhënies në shkollë të zbatohen orientimet dhe synimet e përcaktuara në skeletkurrikul.

## *N nf#usha 3*: Kurrikula e formimit të përgjithshëm

Kurrikula e Përgjithshme hartohet e zbatohet në përputhje me të gjitha dokumentat dhe legjislacionin përkatës. Në këtë kuadër planet lëndore , planet ditore dhe projektet kurrikulare si në formë ashtu edhe në përmbajtje janë në përputhje me udhëzimet e MASR.

Problematikat që vihen re lidhen kryesisht me veprimtaritë mbështeëse për nxënësit me aftësi të kufizuar, si dhe me veprimtaritë e diferencuara për nxënësit me nevoja të veçanta. Gjithashtu puna me projektet kurrikulare në mënyrë që ato realisht të ndihmojnë nxënësit në përpunimin e njohurive të marra dhe zhvillimin e aftësive ndërkurrkulare , ka vend për përmirësime të mëtejshme.

BEQIR ÇELA

Në përfundim, duke patur parasysh edhe pikat që kanë nevojë për përmirësime dhe për përshtatje të mëtejshme, mund të themi që kurrikula e përgjithshme në shkollën “ Beqir Çela “ hartohet dhe zbatohet korrektesisht.

## *N nf#usha 4*: **Mbështetja për zbatimin e kurrikulës**

Për zhvillimin dhe përvetësimin e mësimit teorik profesional mësuesit dhe nxënësit mbështeten në materiale mësimore të përgatitura nga mësuesit e lëndëve profesionale pasi tekstet e mirëfillta për lëndë të ndryshme profesionale mungojnë.

Gjithashtu dhe materialet mësimore në praktikat profesionale përgatiten nga vetë instruktorët.

Mungesa e teksteve shkollore të mirëfillta për lëndët profesionale është një mangësi.Pavarësisht kësaj,duhet të theksohet se bëhet një punë e vazhdueshme nga mësuesit që të gjithë nxënësit të pajisjen me materialet mësimore profesionale sipas lëndëve.

Procesin e mësimnxënies e ndihmojne përdorimi i laboratorëve të praktikës profesionale të pajisur me mjetet e domosdoshme didaktike , po duke patur parasysh numrin e madh të nxënësve në shkollë janë të pamjaftueshëm,prandaj dhe në shkollë funksionon mësimi me turne.

Drejtimi TIK zhvillon procesin mësimor duke shfrytëzuar maksimalisht laboratorët e TIK, të cilët janë të pajisur në mënyrë të tillë që garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Përzgjedhja e teksteve të formimit të përzgjithshem , bëhet ne përputhje me të gjitha procedurat e përcaktuara.Pasi mësuesit diskutojnë për përzgjedhjet e teksteve në ekipin ndërlëndor bazuar tek katalogu i teksteve, përzgjedhjet e tyre i drejtohen komisionit të përzgjedhjeve. Komisioni i përbërë nga mësues,harton procesverbalin së bashku me sasinë e kërkuar të librave që më pas i drejtohet shtëpive botuese, përkatëse.

Një nga problematikat që vihen re është mos përputhja e teksteve me nivelin e nxënësve duke qenë se katallogu ofron tekste standarte në rang kombëtar.Përpara fillimit të vitit të ri shkollor,nxënësit janë të pajisur me tekste shkollore.

## *N nf#usha 5* **: Ekipi kurrikular i IoAFP-së**

Në shkollën “ Beqir Çela “ ekipet lëndore hartojnë planet e veprimtarive të tyre në përputhje me kërkesat e orientimet bazë kurikulare dhe këto plane i parashtrohen ekipit kurrikular dhe drejtorisë së Shkollës për miratim. Ekipi kurrikular në bashkëpunim me ekipet lëndore luan njërol parësor në hartimin dhe zbatimin e programeve të mësimdhënies që përmbush sipas drejtimeve profesionale që ofron shkolla. Ka vend për përmirësim të mëtejshëm në ndërthurjen e punës midis ekipeve të kurrikulës së përgjithshme dhe asaj profesionale, sidomos në përzgjedhjen e projekteve që iu afrohen nxënësvë.

Në përfundim mund të themi që ekipet lëndore dhe ekipi kurikular jane të pavarur në proceset e planifikimit të kurikulës dhe bashkëveprimi midis tyre është shumë i rëndësishëm.

BEQIR ÇELA

## 4.3.Gjykime dhe konkluzione

- Në përfundim të proçesit të vetvlerësimit konstatojmë që është bërë një punë serioze dhe me përkushtim nga të gjithë grupet e punës që u përfshinë në këtë proçes.
- Rezultatet e arritura pas analizës i përgjigjen veprimtarisë së përditshme , sukseseve dhe vështirësive që konstatohen në përditshmërinë e funksionimit të shkollës tonë.
- Ndryshimi i kurikulave për drejtimet e SH.M.T dhe Elektroteknikë kanë sjellë vështirësi dhe në pajisjen e nxënësve më çertifikatat e niveleve .

BEQIR ÇELA

## 4.5 Vlerësimi

| Nënfusha | Treguesi | Nivelet e vlerësimit | Piket | Vleresimi | Total piket |
|---|---|---|---|---|---|
| **1.** Kurrikula në bazë shkolle të AFP-së | 1.1. Plani i zhvillimit të orëve mësimore/Plani mësimor zbatohet në përputhje me kërkesat e Skeletkurrikulës së Kualifikimeve Profesionale. | Shumë mirë | 1.3 | Shumë mirë | 1.4 |
| | 1.1.2. Plani mësimor në shkollat e arsimit profesional hartohet në përputhje me planin mësimor të pasqyruar te Skeletkurrikula e Kualifikimeve (drejtimeve/profileve) Profesionale. | Shumë mirë | 1.4 | | |
| | 1.1.3. Plani mësimor parashikon një shpërndarje korrekte të orëve mësimore të formimit profesional, duke u mbështetur në kontekstin dhe mundësitë reale të shkollës, në zgjedhjet e nxënësve dhe personelin mësimdhënës. | Shumë mirë | 1.5 | | |
| 3. Kurrikulae formimit të përgjithshëm | 3.1. Plani tremujor ose vjetor lëndor zbatohet në përputhje me kërkesat zyrtare të dokumenteve kurrikulare | Shumë mirë | 1.2 | Mirë | 1.8 |
| | 3.2. Plani ditor hartohet sipas rekomandimeve të kurrikulës duke synuar arritjen e rezultateve të të nxënit nga nxënësit | Mirë | 1.7 | | |
| | 3.3. Mësuesi harton në planin ditor dhe rezultate për zhvillimin e aftësive dhe temave ndërkurrikulare | Mjaftueshëm | 2.5 | | |
| | 3.4. Mësuesi realizon projekte kurrikulare që i ndihmojnë nxënësit të përpunojnë njohuritë e mësuara dhe të zhvillojnë më tej aftësitë ndërkurrikulare. | Mirë | 2.3 | | |
| 4. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës | 4.1. Mësuesit përzgjedhin tekstet e nxënësve | Shumë mirë | 1.4 | Mirë | 1.6 |
| | 4.2. IoAFP është e pajisur në mënyrë të mjaftueshme me laboratorë dhe mjete mësimore për zhvillimin e lëndëve teorike. | Mirë | 1.7 | | |
| | 4.3. IoAFP disponon mjedise të veçanta për realizimin e moduleve dhe të praktikave profesionale. | Mirë | 1.5 | | |
| 5.Ekipi kurrikular i IoAFP-së | 5.1. Ekipi kurrikular, ai lëndor dhe ai i instruktorëve në IoAFP luajnë një rol parësor në planifikimin dhe zbatimin e një kurrikule që përmbush kërkesat e kualifikimeve profesionale që ofron. | Shumë mirë | 1.3 | Shumë mirë | 1.3 |
| **Totali (shuma e vlerësimeve të të gjithë treguesve, sipas : https://scvet.al/platforma** | | | | | |
| **Vlerësimi përmbledhës – Fusha “Kurrikula e zbatuar”** | | | | **MIRË** | **1.6** |

## 4.6. Rekomandimet

***Pas analizës dhe rezultateve të proçesit të vetvlerësimit të***

***Fushës " Kurikula e zbatuar" u konstatua:***

1. Domosdoshmëria për ndryshimin e strukturës kurikulare të drejtimeve ,SH.M.T dhe Elektroteknikë që të janë zbatuar në shkollën tonë , për klasat e XI-ta dhe të XII-ta.
2. Rishikimi i planeve të mësimdhënies në teori dhe në praktikë profsionale në përputhje më skeletkurrikulat e kualifikimeve Profesionale.
3. Përmirësimi i punës së ekipit kurrikular , për nxitjen dhe realizimin e projekteve ndërlendore për rritjen e cilësisë të mësimdhënies e mësimnxënies në shkollë .
4. Përmirësimi i kushteve të laboratorëve dhe pajisja e tyre me mjete didaktike mësimore për një performancë më të mirë në realizimin e programeve mësimore.
5. Hartimi i teksteve shkollore profesionale.

Kryetari i Bordit

Luigj Aleksi

Drejtori i Shkollës

Fatmir Mersuri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA ... PROFESIONALE ...
DURRËS